

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE DATA 30 MARS 2023

Nisur nga mungesa e Kryeministrit dhe e ministrit të Brendshëm, thuajse edhe e të gjithë qeverisë, por edhe duke qenë se në çdo rrugë, rrugicë, qytet, nëpër bare, nëpër institucione, ku mendohet se nuk mund të preken, si media, ka shpërthyer dhuna, a kemi ndonjë risk në këtu që vijmë në punë, apo nisemi nga parimi “nuk bie rrufeja në parlament”? Së dyti, pa diskutim, në kushte të tilla të një degradimi të rendit dhe të sigurisë publike dhe ku qytetarët ndihen të pasigurt, duhet që Kryeministri dhe ministri i Brendshëm ta lenë luftën nga twitter-i dhe të vijnë këtu. Është seanca e parë pas ngjarjeve të pandodhura në këtë vend, kur Kryeministri dhe ministri i Brendshëm, që të dy, nuk paraqiten, ashtu siç nuk paraqitet drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Këtu kërkoj edhe ndërhyrjen tuaj, si Kryetare e Kuvendit, sepse as ministri dhe as drejtori i i Përgjithshëm i Policisë nuk paraqiten në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, për të dhënë shpjegime. Është dita sot, kur Kryeministri dhe ministri duhet të paraqiten për të dhënë llogari përpara qytetarëve dhe përpara parlamentit dhe pastaj, pa diskutim, jo vetëm fjalët dhe lufta imagjinare në twitter, por të bëhet “një luftë” reale dhe një reprezalje e shtetit ndaj bandave kriminale në këtë vend, për të treguar që këtu ka qeveri, ka shtet dhe ka institucione. Sjellja dhe reagimi i qeverisë në kushte të tilla, duke mos u interesuar për jetët njerëzore dhe për rendin e sigurinë në këtë vend, pa diskutim, janë shqetësuese. Faleminderit!